



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

*Dokument parlamentar*

**RAPORT**

**PËR PROJEKTLIGJIN “ PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
AKTIN FINAL TË KONFERENCËS SË SHTETEVE ANËTARE TË KONVENTËS  
NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET E KUALIFIKIMIT, CERTIFIKIMIT DHE  
SHËRBIMIT PËR DETARËT”**

**- HYRJE**

Komisioni për Politikën e Jashtme, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të Konferencës së Shteteve Anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët”.

Relatore për këtë projektligj ishte deputetja Znj. Elona Gjebrea.

Komisioni e shqyrtoi projektligjin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

**- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të Konferencës së Shteteve Anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

**- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT**

Qëllimi i projektligjit është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Aktin final të Konferencës së Shteteve Anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët. Kërkesa për miratimin e këtij projektligji vjen në zbatim të detyrimeve që

ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Akti Final i Konventës parashikon ndryshime që përditësojnë standardet veçanërisht në dritën e ndryshimeve teknologjike, prezantojnë kritere dhe metodologji të reja kualifikimi dhe atestimi, detajojnë kriteret e orëve të punës dhe të pushimit për detarët, parandalimin e abuzimit me drogë dhe alkool, përcaktojnë standardet e gjendjes shëndetësore të detarëve si dhe synojnë të përfshijnë metodologji dhe kërkesa të reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne.

Nga miratimi i këtij akti pritet të ketë një përmirësim të ndjeshëm të standardeve kombëtare të nevojshme për trajnimin dhe kualifikimin e marinarëve të sotëm, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare. Dispozitat e aktit final do të jenë të detyrueshme jo vetëm për detarët por edhe për pronarët e anijeve, institucionet e trajnimit dhe administratat kombëtare detare.

#### **- EFEKTET FINANCIARE**

Miratimi i këtij projektligji nuk do të sjellë efekte financiare as për buxhetin e shtetit dhe as për detarët, por thjesht do përditësojë kurrikulat e trajnimeve, duke përmirësuar leksionet në përputhje me zhvillimet e reja që kanë ndodhur në fushën e transportit detar nga koha e hyrjes në fuqi të Konventës deri më sot.

#### **- PËRFUNDIME**

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme, vlerësoi se:

- **Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

**RELATORE**

**ELONA GJEBREA**

**KRYETARE**

**MIMI KODHELI**